



Breaking News:

Policia e Shtetit/Njoftim



Lajmet

13/05/2023

Mallakastër – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Ndërprerja”

Konstatohet dhe goditet një rast i tentativës për të tregtuar fara narkotike cannabis sativa, me qëllim kultivimin.

Mbante në banesë, 1127 fara kanabisi dhe fishekë luftarak, arrestohet 19-vjeçari.

Në pranga edhe një 18-vjeçar, pasi dyshohet se blinte fara kanabisi, me qëllim kultivimin.

Sekuestrohen farat narkotike dhe municion luftarak.

Në vijim të goditjeve të njëpasnjëshme ndaj veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve dhe Sektorit Operacional të DVP Fier, të mbështetura nga intelijenca informative, për një rast të tregtimit të farave të kanabisit, me qëllim kultivimin, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Ndërprerja”, në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit T. K., 19 vjeç, banues në fshatin Lofkënd, Mallakastër dhe K. N., 18 vjeç, banues në fshatin Aranitas, Mallakastër.

Në banesën e 19-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën 1127 fara narkotike të dyshuara cannabis sativa, si dhe krehër me 30 fishekë luftarak.

Nga veprimet hetimore dyshohet se 18-vjeçari i kishte blerë shtetasit T. K., fara kanabisi, me qëllim kultivimin.

Farat narkotike dhe municioni luftarak u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Shkodër – U kapën në flagrancë duke transportuar 50 qese me ushqime, për përfitime elektorale, vihen në pranga 3 punonjës të bashkisë Shkodër

Policia e Shtetit – Përfundoi në të gjithë vendin, instruktazhi i punonjësve të Policisë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor 2023 ▶